
Analizë e përmbajtjeve me bazë gjinore



Politikanet dhe paragjykimet mediatike

Botues:
Instituti për Studime të Komunikimit
rr. “Jurij Gagarin” 17-1 / 1, Shkup
www.iks.edu.mk

Rreth botuesit:
prof. dr. ZanetaTrajkoska

Edicioni:
ResPublica

Autore:
mr. Bojana Jovanovska
mr. Sara Milenkovska

Redaktor:
mr. Dejan Andonov

Përkthyer nga gjuha maqedonase:
Vjosa Taipi

Titulli origjinal:
Анализа на родово-базирани содржини – Политичарките и медиумската пристрасност

Dizajn grafik:
Igor Delov

Redaktimi grafik:
Ljuben Dimanovski

Vendi dhe viti:
Shkup, 2024

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека “Св. Климент Охридски”, Скопје

305-055.1/.2:32(497.7)(047.31)
32-055.2:342.8(497.7)”2024”(047.31)
32-055.2:[316.774:004.738.5(497.7)”2024”(047.31)

JOVANOVSKA, Bojana
Analizë e përmbajtjeve me bazë gjinore [Електронски извор] : politikanet dhe paragjykimet mediatike / [autore Bojana Jovanovska, Sara Milenkovska; përkthyer nga gjuha maqedonase Vjosa Taipi]. - Shkup: Instituti për studime të komunikimit, 2024. - (Edicioni ResPublica)

Начин на пристапување (URL):
https://respublica.edu.mk/wp-content/uploads/2024/06/politikanet-dhe-paragjykimet-mediatike.pdf
(албански јазик). - Превод на делото: Анализа на родово-базирани содржини : политичарките и медиумската пристрасност. - Текст во PDF формат, содржи 46 стр., илустр. - Наслов преземен од екранот. - Опис на изворот на ден 05.07.2024. - Фусноти кон текстот

ISBN 978-608-4805-41-0

1. Milenkovska, Sara [автор]
а) Родова еднаквост -- Политика -- Македонија -- Истражувања б) Родово базирани наративи -- Онлајн медиуми -- Жени политичарки -- Претседателски и парламентарни избори -- Македонија -- 2024 -- Истражувања

COBISS.MK-ID 64028165

PËRMBAJTJA

HYRJE.....4

METODOLOGJIA.....7

BARAZIA GJINORE NË
POLITIKËN MAQEDONASE.....9

STUDIM I RASTIT: NARRATIVAT ME BAZË
GJINORE GJATË FUSHATAVE PËR ZGJEDHJET PRESIDENCIALE
DHE PARLAMENTARE NË VITIN 2024.....13

DISKUTIM PËRFUNDIMTAR.....41

SHËNIME PËRFUNDIMTARE.....44

Hyrje

Sipas një analize të fundit të Economist Intelligence Unit, mesatarisht 85% e grave në nivel global kanë përjetuar ose kanë qenë dëshmitare të dhunës në internet, me taktikat më të përdorura që përfshijnë dezinformatat dhe shpifjen, ngacmimin kibernetik dhe gjuhën e urrejtjes.[1] E gjithë kjo kontribuon në rritjen e hendekut digjital gjinor, me rezultatin që pothuajse 9 nga 10 gra kufizojnë aktivitetin e tyre në internet, duke kufizuar kështu qasjen në punësim, arsim dhe kujdes shëndetësor, por edhe pjesëmarrjen në flukset shoqërore.[2] Gratë në politikë janë veçanërisht të ndjeshme ndaj dhunës në internet për shkak të domosdoshmërisë së pranisë së tyre në online hapësirën si pjesë e angazhimeve të tyre profesionale, veçanërisht gjatë periudhave zgjedhore.

Dhuna me bazë gjinore minon pjesëmarrjen e grave në politikë duke ngjallur frikë dhe frikësim, duke krijuar pengesa për qasje dhe pjesëmarrje, duke ndikuar në shëndetin dhe mirëqenien mendore të grave dhe duke kufizuar praninë e perspektivave të ndryshme në institucionet politike. Dhuna me bazë gjinore dhe gjuha e urrejtjes në sferën digjitale bazohen në stereotipet gjinore, duke përforcuar nocionet tradicionale të roleve dhe normave gjinore që kufizojnë pjesëmarrjen e grave në politikë. Përmes ngacmimeve në internet, komenteve seksiste dhe narrativeve misogjiniste, gratë në politikë shpesh i nënshtrohen portretizimeve poshtëruese që përforcojnë stereotipet e grave si udhëheqëse të dobëta, emocionale ose të paafta. Këto narrative jo vetëm që diskreditojnë arritjet politike të grave, por gjithashtu dekurajojnë gratë e tjera që të hyjnë në arenën politike, duke forcuar idenë se vendi i tyre nuk është në politikë. Në këtë mënyrë, hapësira digjitale shërben si një mjet i fuqishëm për përjetësimin e stereotipeve të dëmshme dhe pengimin e pjesëmarrjes së plotë dhe të barabartë të grave në politikë.

1 Economist Intelligence Unit. (2020). Measuring the prevalence of online violence against women. Në dispozicion në lidhjen tjetër.

2 Ibid.

Dhuna me bazë gjinore në politikë më së shpeshti synon gratë jo për shkak të pikëpamjeve të tyre politike, por sepse ato janë gra, me qëllimin përfundimtar për t'i parandaluar ato të dëgjohen dhe të jenë aktive në diskursin publik. Përmes ngacmimit gjinor të grave në politikë, i cili mund të ndikojë në vetë-censurimin dhe të kontribuojë në përfaqësimin e tyre më të ulët në sferën publike, një mesazh u dërgohet në të vërtetë të gjitha grave për rolin dhe vendin e tyre në shoqëri. Megjithëse si burrat ashtu edhe gratë mund të jenë viktima të dhunës politike, specifikat e dhunës ndaj grave në politikë kanë tre karakteristika të dallueshme: targeton gratë për shkak të gjinisë së tyre, mund të jetë e bazuar në gjini në formën e vet, siç ilustrohet nga kërcënimet seksiste dhe dhuna seksuale, dhe i dekurajon gratë të jenë politikisht aktive.[3]

Përdorimi në rritje i mediave sociale si instrumente veçanërisht të rëndësishme për kryerjen e fushatave politike, janë kthyer në një hapësirë ku dhuna online ndaj grave në politikë do të shënojë kulmin e vet. Nga njëra anë, mediat sociale janë mjete të rëndësishme që gratë kandidate dhe politikane të komunikojnë drejtpërdrejt me elektoratin e tyre, duke bajpasuar margjinalizimin dhe paragjykimin me të cilin përballen në mediat tradicionale, ndërsa nga ana tjetër, t'i ekspozojnë ato ndaj sasive të konsiderueshme të seksizmit, ngacmimeve dhe kërcënimeve, me një efekt të dëmshëm mbi ambiciet politike të grave të reja.[4] Mediat sociale ndikojnë ndjeshëm në formimin e qëndrimeve në lidhje me aftësitë politike të grave dhe përfaqësimin e grave, ku përforcimi i stereotipeve negative gjinore në mediat sociale do të ndikojë në mënyrë të pashmangshme në përforcimin e qëndrimeve misogjiniste në lidhje me rolin e grave në politikë.

3 Hubbard, C. dhe DeSoi, C. (2016). Votes without violence- A Citizen Observer's Guide to Addressing Violence Against Women in Elections. National Democratic Institute. Në dispozicion në lidhjen tjetër.

4 Di Meco, L. (2020). Online Threats to Women's Political Participation and The Need for a Multi-Stakeholder, Cohesive Approach to Address Them. UN Women. Në dispozicion në lidhjen tjetër.

Pavarësisht dyfishimit të përfaqësimit të grave në parlamente në nivel global, vlerësohet se arritja e barazisë gjinore në trupat ligjvënëse mund të arrihet më së shpejti në vitin 2063[5], gjë që nuk përjashton situatën në Maqedoninë e Veriut, duke pasur parasysh se tendenca e pjesëmarrjes së grave në poste të larta politike nuk tregon ndonjë ndryshim të rëndësishëm në vitet e fundit. Përveç kësaj, prania në media e grave politikane është ende e ulët, kështu që në zgjedhjet e fundit parlamentare në vitin 2020, pavarësisht se përbënin 42% të kandidatëve/eve të regjistruar/e, mbulimi i grave politikane nga media ndryshonte midis 4% dhe 14%.[6]

Duke analizuar përdorimin e stereotipeve gjinore në raportet gazetareske, kjo analizë synon të identifikojë narrativat e dëmshme gjinore dhe gjuhën e urrejtjes me bazë gjinore në hapësirën online që synon gratë në politikë, gjatë zgjedhjeve presidenciale dhe parlamentare të vitit 2024 në Maqedoninë e Veriut. Kështu, analiza mbulon përmbajtje me bazë gjinore që synon diskreditimin dhe përjashtimin e grave politikane nga diskursi publik. Qëllimi përfundimtar i analizës është të theksojë se si mediat kontribuojnë në krijimin dhe përhapjen e narrativeve të dëmshme gjinore për gratë në politikë në hapësirën online, në mënyrë që të gjenden mënyra për ta bërë atë hapësirë më të sigurt për pjesëmarrjen e politikaneve femra.

Kjo analizë, e titulluar "Politikanet dhe paragjykimet mediatike", është analiza e dytë e përmbajtjeve me bazë gjinore e përgatitur nga Instituti për Studime të Komunikimit në kuadër të projektit "Përdorimi i gazetarisë së bazuar në fakte për rritjen e ndërgjegjësimit dhe për kundërshtimin e dezinformatave në hapësirën mediatike në Maqedoninë e Veriut", i cili zbatohet me mbështetjen e Ambasadës Britanike në Shkup.

5 United Nations Economic and Social Council. (2020). Commission on the Status of Women - Sixty-fifth session 15–26 March 2021, Women's full and effective participation and decision-making in public life, as well as the elimination of violence, for achieving gender equality and the empowerment of all women and girls. Në dispozicion në lidhjen tjetër.

6 ODIHR. (2020). REPUBLIC OF NORTH MACEDONIA EARLY PARLIAMENTARY ELECTIONS 15 July 2020, ODIHR Special Election Assessment Mission Final Report. NNë dispozicion në lidhjen tjetër.

Metodologjia

Duke përfshirë analizën e raporteve gazetareske të publikuara në mediat online dhe faqet e internetit të mediave tradicionale, si dhe komentet mbi raportet gazetareske mbi profilet e mediave në platformat sociale, ky hulumtim mbuloi përpunimin e një studimi rasti, duke aplikuar analizën cilësore të përmbajtjes së botuar në periudhën nga marsi deri në maj 2024, pra nga afati zyrtar për dorëzimin e kandidaturave presidenciale në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ) më 19 mars, deri në raundin e dytë të zgjedhjeve presidenciale më 8 maj, i cili përkoi me zgjedhjet parlamentare. Megjithëse narrativet me bazë gjinore me konotacion të gabuar dhe gjuha e urrejtjes me bazë gjinore ishin të pranishme shumë më herët[7] , në fillim të vitit, në momentet e para kur emrat e kandidatëve të mundshëm filluan të spekulohen në publik, kjo analizë u përqendrua në narrativet që rezultuan nga kandidatura zyrtare e grave për funksionin e presidentit, si dhe për përfaqësuesit në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Mostra që u analizua përbëhet nga 14.000 raporte gazetareske të publikuara në internet dhe 4.183 postime me gjithsej 20.761 komente mbi raportet gazetareske mbi profilet e mediave në platformat sociale, përkatësisht në Facebook, Instagram, TikTok dhe YouTube.

Kështu, u analizuan të gjitha raportet gazetareske që përfshijnë elemente me bazë gjinore, përkatësisht tema që lidhen me politikanet femra, barazinë gjinore, diskriminimin me bazë gjinore dhe gjuhën e urrejtjes ndaj politikaneve femra, si dhe dhunën me bazë gjinore.

7 Shih më shumë në: Kandidatet stigmatizohen sepse janë gra

Përmbajtja me bazë gjinore u analizua përmes disa aspekteve specifike:

- Përdorimi i stereotipeve gjinore[8]
- Përdorimi i gjuhës sensacionaliste[9]
- Përdorimi i gjuhës seksiste dhe gjuhës së urrejtjes[10]
- Përdorimi i dezinformatave gjinore[11]
- Inkurajimi i një kulture të dhunës me bazë gjinore[12]
- Përfshirja e rishikimit kritik dhe kontekstit më të gjerë në raportet gazetareske.

8 Stereotipet gjinore janë pikëpamje të përgjithësuara ose paragjykime për atributet ose karakteristikat ose për rolet që janë ose duhet të mbahen ose kryhen nga gratë dhe burrat. (Gender stereotyping | OHCHR)

9 Përdorimi i gjuhës që synon të shkaktojë një ndjesi, të zgjojë interes ose tronditje të madhe edhe duke shtrembëruar faktet.

10 Gjuha seksiste përjetëson diskriminimin ose paragjykimin në bazë të gjinisë, ndërsa gjuha e urrejtjes nxit dhunën ose armiqësinë ndaj individëve ose grupeve në bazë të gjinisë dhe identitetit të tyre gjinor.

11 Dezinformimi gjinor i referohet aktiviteteve (krijimi, ndarja, shpërndarja e përmbajtjeve) që sulmojnë ose minojnë reputacionin e njerëzve në bazë të gjinisë së tyre dhe keqpërdorin stereotipet gjinore për të promovuar qëllimet politike, sociale ose ekonomike. (ENGENDERING HATE | Demos)

12 Një kulturë e dhunës me bazë gjinore i referohet normave, qëndrimeve dhe praktikave shoqërore që perceptojnë, miratojnë dhe kështu normalizojnë dhunën ndaj individëve në bazë të gjinisë së tyre.

Barazia gjinore në politikën maqedonase

Me paraqitjen e spekulimeve të para në lidhje me emrat e kandidatëve dhe kandidateve të mundshëm për zgjedhjet presidenciale të këtij viti në Maqedoninë e Veriut, u vu re tallja dhe gjuha e urrejtjes në hapësirën online, por ajo që ishte veçanërisht e habitshme kur bëhej fjalë për gratë kandidate ishte konteksti gjinor i këtyre fyerjeve.13 Pritjet shoqërore dhe rolet tradicionale gjinore, të cilat janë ende jashtëzakonisht patriarkale në shoqërinë tonë, ndikojnë në formësimin e perceptimeve të grave në role udhëheqëse, si në politikë, dhe dhunën me bazë gjinore në të cilën ato shpesh janë viktima në hapësirën online, tregon se ende perceptohen si një përjashtim në diskursin publik. Sulmet në internet me kontekst gjinor përfaqësojnë një mjet shkatërrues që mund të përdoret në mënyra të ndryshme gjatë ciklit zgjedhor në mënyrë që të pengojë gratë të marrin pjesë si kandidate, votuese, përfaqësuese të zgjedhjeve, vëzhguese ose aktiviste.14 Prandaj, është me rëndësi të veçantë që raportimi i mediave gjatë proceseve zgjedhore të mos kontribuojë në krijimin dhe përhapjen e narrativave që dëmtojnë gjininë. Heteronormativiteti dhe vlerat patriarkale argumentojnë se gratë janë shumë të paqëndrueshme emocionalisht ose mendërisht për udhëheqje, duhet t'i japin përparësi familjes mbi karrierën dhe duhet t'i përmbahen standardeve konvencionale të feminitetit në pamje dhe sjellje. Liderët femra shpesh kritikohen padrejtësisht se janë shumë të buta ose shumë agresive, përkatësisht kritikohen duke zbatuar standarde të dyfishta. Paragjykime të tilla jo vetëm që përjetësojnë pabarazinë gjinore, por gjithashtu parandalojnë gratë e afta të kontribuojnë plotësisht në jetën politike. Dhe një raport i fundit i UN Women15 thekson se gratë në pozita udhëheqëse ende

13 Shih më shumë në: Kandidatet stigmatizohen sepse janë gra

14 Hubbard, C. dhe DeSoi, C. (2016). Votes without violence- A Citizen Observer's Guide to Addressing Violence Against Women in Elections. National Democratic Institute. Në dispozicion në lidhjen tjetër.

15 Women in power in 2023: New data shows progress but wide regional gaps

përballen me përfaqësim të ulët dhe dhunë të konsiderueshme, si online ashtu edhe offline, e cila përfshin sulme personale që synojnë shëndetin dhe stabilitetin e tyre mendor.

Në vitin 2022, indeksi i barazisë gjinore në Maqedoninë e Veriut ishte 64.5 pikë nga maksimumi 100, me një përparim prej 2.5 pikë krahasuar me vitin 2019. Me këtë ritëm, vendit do t'i duhen rreth 57 vjet për të arritur barazinë gjinore në të gjitha fushat[16]. Disa[17] raporte kombëtare dhe ndërkombëtare zbulojnë problemet më të mëdha në zbatimin e politikave që do ta afronin vendin me arritjen e barazisë gjinore. Përveç kësaj, në vitet e fundit, temat që lidhen me barazinë gjinore janë vënë nën kërcënim serioz nga lëvizjet kundër gjinisë, veprimi i të cilave është në thelb një sfidë për të ashtuquajturën "ideologji gjinore" dhe që përdor mediat sociale si një mjet themelor, kryesisht duke krijuar dhe shpërndarë dezinformimin gjinor, i cili më së shpeshti synon politikanet dhe aktivistet.[18] Për të kuptuar pozicionin e grave në politikë, duhet të shihet përmes një perspektive ndër-sektoriale, përkatësisht, se si pabarazitë strukturore, diskriminimi sistematik dhe veprimi i zgjeruar i lëvizjeve kundër gjinisë kufizojnë të drejtat dhe liritë e grave në përgjithësi, dhe kështu hyrjen në politikë.

Legjislacioni dhe Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut luajnë zyrtarisht një rol në afirmimin e barazisë gjinore në vend. Politikat dhe angazhimet për barazinë gjinore të Maqedonisë së Veriut datojnë edhe para se termi "barazi gjinore" të bëhej pjesë e legjislacionit. Strategjia e parë për Barazi Gjinore 2013-2020 u miratua në vitin 2013 në bazë të nenit 9 paragrafi 3 të Ligjit për mundësi të barabarta të grave dhe burrave, ndërsa në vitin 2022 u miratua Strategjia aktuale për periudhën 2022-2027. Megjithatë, pavarësisht angazhimeve formale, barazia gjinore, veçanërisht gjatë vitit të kaluar, ka dobësuar vullnetin politik për promovimin e saj, kryesisht përmes zvogëlimit që nga miratimi i Ligjit të ri për barazi gjinore.

16 Gender Equality Index for North Macedonia (2022) | Publications | UN Women – Europe and Central Asia

17 1 Indeksi i Barazisë Gjinore në Maqedoninë e Veriut 2022

18 Shih më shumë në: Jovanovska, B. dhe Jovanovska Kanurkova, J. (2023). Analiza e përmbajtjeve me bazë gjinore: Barazia gjinore në një kohë të dezinformatave gjinore. ИКС. Në dispozicion në lidhjen tjetër.

Përbërja fillestare e Kuvendit pas zgjedhjeve parlamentare të 8 majit 2024 numëronte vetëm 38 gra (31.6%). Në qeverinë e mëparshme, gratë mbanin vetëm 4 nga 20 postet ministrore (20%) dhe vetëm 2.5% e pozitave komunale janë gra. Ajo që është e rëndësishme të theksohet është se pavarësisht kuotave të garantuara në Kodin zgjedhor për 40% të përfaqësimit të grave në Parlament, nevojiten reforma sistematike që do të ndikonin në kulturën e normalizimit të dhunës politike ndaj grave. Doracaku për barazi gjinore dhe fuqizim 2020[19] thekson se gratë përfaqësohen më mirë vetëm në institucionet ku zbatohet një kuotë gjinore, siç janë Kuvendi dhe këshillat në nivel komunal.

Gjetjet e vëzhgimit të ODIHR-it për zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare të vitit 2024 tregojnë për nën-përfaqësim të pozicioneve të ndryshme të zgjedhura dhe të emëruara, të kombinuara me raste të presioneve dhe sulmeve në internet ndaj politikaneve femra, që gjithashtu do të thotë përpjekje të pamjaftueshme nga autoritetet dhe partitë politike për të adresuar stereotipet e vazhdueshme gjinore që pengojnë pjesëmarrjen e grave në politikë.[20] Sipas ODIHR-it, përmbajtja e fushatave në rrjetet sociale përfshinte video, fotografi, përshkrime të takimeve dhe fjalimeve, ndërsa, nga ana tjetër, ndërveprimet më të mëdha midis 21 marsit dhe 8 majit 2024, lideri i VMRO-DPMNE-së kishte nivelin më të lartë të angazhimit në internet (753.082 ndërveprime), pasuar nga kandidati presidencial i mbështetur nga VLEN (300,467 ndërveprime) dhe kandidati presidencial i mbështetur nga LSDM (283,002 ndërveprime)[21]. Ajo që vuri në dukje raporti i ODHIR, dhe që u konfirmua gjatë kësaj analize, është se çështjet që lidhen me barazinë gjinore u neglizhuan kryesisht në diskursin e fushatës, me përjashtim të kandidatit presidencial të mbështetur nga koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE. Në shumicën e ngjarjeve të tjera, referencat në lidhje me gratë i referoheshin roleve të tyre brenda familjes, duke reflektuar kështu stereotipet gjinore dhe diskriminimin ndaj familjeve jo-tradicionale.

19 Barazia gjinore është e rëndësishme

20 ODIHR. (2024). Zgjedhjet parlamentare dhe raundi i dytë i zgjedhjeve presidenciale, 8 maj 2024 - PËRFUNDIME PARAPRAKE. NNë dispozicion në lidhjen tjetër.

21 Ibid.

Në kontekstin e kësaj analize, është e rëndësishme të theksohet roli i mediave dhe rrjeteve sociale në riprodhimin e pabarazisë. Mediat tradicionale në Maqedoninë e Veriut rregullohen me Ligjin për media dhe Ligjin për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele.[22] Ndërsa këto ligje nuk mbulojnë mediat online, ka ligje të tjera që i rregullojnë ato, siç janë Kodi penal, Ligji për përgjegjësinë civile për fyerje dhe shpifje dhe Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale. Aktualisht, nuk ka rregullim të mediave sociale, gjë që krijon një vakum ku gjuha e urrejtjes dhe përmbajtja e dëmshme mund të përhapen[23].”Udhëzime për raportimin etik të mediave online”[24] tregojnë se mediat nuk duhet të fshehin informacione të rëndësishme që mund të ndikojnë në kuptimin e përmbajtjes nga lexuesit. Heshtja e fakteve që mund të ndikojnë ndjeshëm në formimin e një qëndrimi është e njëjtë me shtrembërimin e qëllimshëm të realitetit dhe krijimin e dezinformimit. Mediat duhet të kontrollojnë pretendimet e subjekteve politike ose burimeve të tjera për të ndihmuar audiencën të dallojë faktet nga spekulimet, veçanërisht për tema të rëndësishme dhe aktuale.

22 Jovanovska, B. dhe Jovanovska, J. (2023). Analiza e përmbajtjeve me bazë gjinore: Barazia gjinore në një kohë të dezinformatave gjinore. ИКС. Në dispozicion në lidhjen tjetër.

23 Ibid.

24 CEMM. (2021). Udhëzime për raportim etik të online mediave Në dispozicion në lidhjen tjetër.

STUDIM I RASTIT:

Narrativat me bazë gjinore gjatë fushatave për zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare në vitin 2024

Dorëzimi i kandidaturave për zgjedhjet presidenciale

Më 19 mars 2024 ishte afati i fundit për dorëzimin e kandidaturave për zgjedhjet presidenciale në Komisionin Shtetëror Zgjedhor (KSHZ), ku shumica e mediave raportuan informacione për kandidatët e paraqitur dhe partitë që mbështesin kandidatët dhe kandidatët, si dhe informacione jozyrtare për listat e kandidatëve për zgjedhjet parlamentare.

Vetëm një raport gazetaresk raporton vizitën e Ministres së Kulturës Bisera Kostadinovska Stojçevska në TV Tera me titull Kostadinovska-Stojçevska **: Unë përpiqem të mbroj familjen time nga botet partiake, si një politikane femër jam më e rrezikuar,**[25] në të cilën ajo flet për diskriminimin me të cilin përballet si grua në politikë ndaj kolegëve të saj, duke deklaruar se

> *pyetjet më të zakonshme nuk ishin ato që unë do të avokoja si ministre, por pyetjet në lidhje me jetën private. Në një intervistë, i pyeta nëse ata ua bëjnë këto pyetje edhe kolegëve të mi meshkuj, dhe ata thanë - jo, jo,*”,

25 Kostadinovska-Stojçevska: Përpiqem të mbroj familjen time nga botet partiake, si një politikane femër jam më e rrezikuar - Centar.mk

dhe se ka përdorues të mediave sociale që abuzojnë me fotot e fëmijëve të saj, por që çdo sulm vetëm forcon karakterin e saj. Në të njëjtën kohë, në disa raporte gazetareske, raportohen edhe deklarata nga vizita e saj në TV Klan, por vetëm tre nga raportet përcjellin deklaratën në të cilën ajo thotë se në kuadër të LSDM-së

> *para së gjithash, mbrojmë ruajtjen e atij parimi të përfaqësimit mashkull-femër ose të përfaqësimit të barabartë të grave në lista. Që nga zgjedhjet e mëparshme parlamentare, ajo është kthyer në një retorikë që është bartëse dhe bashkë-bartëse, përkatësisht me atë përfaqësim, mbulohet një rajon pak më i madh. Që do të thotë se përveç parimit mashkull - femër, do të kemi diçka që quhet bartës dhe bashkë-bartës për secilën njësi zgjedhore.*[26]

Megjithëse shumica e mediave raportuan për paraqitjet publike të ministres, vetëm rreth 20% e tyre raportuan deklarata në lidhje me çështjen e barazisë gjinore.

Vetëm një postim përcjell deklaratën e aktivistes Irena Cvetkoviq, në lidhje me aktivitetin e grave në politikë, duke thënë se

> *Fatkeqësisht, gratë politikane që janë të angazhuara për barazi gjinore, vitet e fundit janë përballur dhe janë vënë në shënjestër, jo vetëm nga gjuha e urrejtjes, por edhe nga thirrjet për dhunë ndaj tyre. Ato janë gra të forta dhe mund t'i rezistojnë këtyre goditjeve, por ajo që është e rrezikshme është se asnjë politikane dhe grua e re, që në të ardhmen që dëshiron të hyjë në politikë nuk do të dojë të merret me këto çështje. Ne kemi pesë deputete femra në Kuvend që ishin në shënjestër çdo ditë, me thirrje për përdhunim, të lyhen me katran ose të vriten në shesh sepse kanë mbështetur futjen e Ligjit për barazi gjinore në Kuvend.*[27]

Pesëdhjetë raporte gazetareske në ditët në vijim publikuan informacion në lidhje me hapjen e një rasti nga Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK) për prokurimin e helikopterëve nga Ministria e Mbrojtjes, ku përmendet ministrja

26 Kostadinovska Stojçevska: Listat përfundimtare për kandidatët për deputetë do të dihen të shtunën në Kongresin e LSDM-së | Shtypi24

27 Cvetkoviq: Pesë deputetë ishin vënë në tapet çdo ditë, me thirrje për përdhunim dhe lyerje me katran sepse mbështetën pranimin e Ligjit për barazi gjinore në Kuvend - MAKTEL

aktuale Slavjanka Petrovska. Raportet gazetareske në lidhje me këtë rast, ndër të tjera, përcjellin reagimin e Aleksandar Nikolloskit nga VMRO-DPMNE në lidhje me rastin, të cilin ministri e thërret për duel. Përveç kësaj, raportet gazetareske përcjellin reagimin e Jovana Trençevska nga LSDM-ja, ndaj akuzave të ministrit të Punës dhe Politikës Sociale Gjoko Vellkovski për pagesa të paligjshme të ndihmës sociale. Në të njëjtën kohë, pesëmbëdhjetë media kanë raportuar për konferencën për shtyp të LSDM-së në të cilën deputetja Lidija Tasevska i bëri thirrje kandidates presidenciale Gordana Siljanovska-Davkova t'u kërkojë falje pensionistëve për fyerjet me të cilat i krahasoi ato me "Muppet Show". Shtatë media raportojnë për vizitën e Marija Miteva nga VMRO-DPMNE në lajmet në TV Alsat-M ku ajo deklaron se **Siljanovska është superiore ndaj kandidatëve të tjerë.**[28]

Ajo që bie në sy është se raportet e lajmeve përcjellin në mënyrë shterpe informacionin dhe deklaratat në rendin që ato shfaqen, pa dhënë ndonjë vështrim kritik ose analizë më të gjerë.

Më 20 mars filluan akuzat e ndërsjella në lidhje me kandidatët presidencialë, me fokus në mënyrën në të cilën u mblodhën nënshkrimet për Siljanovska-Davkova. Në pritje të konfirmimit të kandidaturave nga KSHZ-ja, mediat në ditët në vijim publikojnë komente të ndryshme për kandidaturat dhe informacione zyrtare dhe jozyrtare për kandidatët dhe mbajtësit e listave për zgjedhjet parlamentare, përfshirë Sanja Llukarevska nga LSDM, Monika Zajkova nga LDP dhe Vesna Bendevska nga ZNAM.

Më 21 mars, një raport gazetaresk raporton deklaratat e analistit politik Aleksandar Ristevski me titull **Siljanovska-Davkova do të jetë nëna e kombit: Këto zgjedhje do të korrigjojnë gabimin historik të pesë viteve më parë.**[29] Dhjetëra media raportojnë deklarata nga Mirjana Najçevska nga Partia Tvoja me komente mbi listën e zezë të SHBA-ve.

28 Zëdhënësja e VMRO-DPMNE-së: Siljanovska është superiore ndaj kandidatëve të tjerë - Free Press

29 Siljanovska Davkova do të jetë nëna e kombit: Këto zgjedhje do të korrigjojnë gabimin historik të pesë viteve më parë - TV Alfa

Njëzet raporte gazetareske raportojnë vizitën e ministres Petrovska në TV Sitell me fokus në prokurimin e helikopterëve, por vetëm një në të cilën ajo deklaron se

> *jam e gatshme dhe kam kapacitetin të jem bartëse e listës nëse vendoset kështu. Kam kapacitetin dhe mund të jem një nga kandidatët në listën më poshtë.*"[30]

Dhjetë raporte përcjellin deklaratën e PRSD-së se Siljanovska u bë viktimë e propagandës së VMRO-DPMNE-së për[31] shkak të mënyrës se si partia siguroi nënshkrimet për kandidaturën e saj.

Pothuajse të gjitha mediat më 21 mars raportojnë se kandidati presidencial Bujar Osmani nuk i bëri thirrje për iftar kandidates presidenciale Biljana Vankovska dhe kandidatit presidencial Stevço Jakimovski, ndërsa sensacionalizmi raportohet veçanërisht në titujt, si: "**Vankovska mori dysh nga Osmani, dhe ajo ia dha Pendarovskit!**"[32]

Nga ana tjetër, vetëm dhjetëra media ndajnë pjesëmarrjen e Zëvendëskryeministrit Bojan Mariçiç në panelin për diskutim "Gratë në organet e qeverisjes - sektori i forcuar i biznesit, shoqëri e forcuar" me tituj të tillë si "**Beteja për barazinë gjinore nuk është vetëm një luftë e grave, është një përpjekje kolektive".**[33] Për më tepër, po aq raporte gazetareske i referohen konferencës me titull "Gratë e suksesshme për një rajon të suksesshëm", duke raportuar deklaratat e Fatmir Bytyqit nga LSDM-ja i cili thotë se

> *duhet të njohim kontributet e grave dhe të ndërmarrim hapa për të siguruar pjesëmarrjen e tyre të plotë në proceset e vendimmarrjes. Kjo nuk është çështje e lejes, por e drejtësisë dhe barazisë. Talenti dhe potenciali anashkalohen dhe diskriminohen padrejtësisht, "*[34]

30 Petrovska: kam kapacitetin të jem bartëse e listës, por jam e gatshme të mos gjendem fare në to, autoritetet e LSDM-së do të marrin vendimin - 360 gradë

31 PRSD: Kandidatja e pavarur presidenciale Siljanovska Davkova është bërë e varur nga VMRO-DPMNE - Fokus

32 Vankovska mori shportë nga Osmani, dhe ajo ia dha Pendarovskit!

33 Mariçiç: Beteja për barazinë gjinore nuk është vetëm një luftë e grave, është një përpjekje kolektive | Shtypi24

34 Konferenca në Shkup: Në garën për barazi, gratë konkurrojnë me këmbët e lidhura | Meta.mk

si dhe Sllavica Grkovska nga LSDM-ja se

> *gratë që përballen me pengesa janë më të motivuara në luftën për një shoqëri më të mirë".* [35]

Ndërsa mbështetja e potencialit të grave është e një rëndësie të veçantë gjatë fushatave zgjedhore, fokusi i raporteve gazetareske është ende kryesisht në tema të tjera politike.

Publikimi i listave të kandidatëve për zgjedhjet parlamentare

Në ditët në vijim, raportet e lajmeve fillojnë të publikojnë informacione në lidhje me listat e kandidatëve për zgjedhjet parlamentare, si dhe programet e partive.

Tre media raportojnë se ish-deputetja Snezhana Kalevska-Vançeva nuk është në listat e kandidatëve të LSDM-së, me raporte që duket se nuk kanë ndonjë qëllim të veçantë, as nuk japin ndonjë kontekst.

Më 24 mars, disa raporte gazetareske raportuan zgjedhjen e Maja Moraçanin nga DOM si kandidate në zgjedhjet parlamentare, ndërsa në disa nga titujt, por edhe në tekstin e raporteve u bë i dukshëm mospërdorimi ose përdorimi i paqëndrueshëm i feminitivëve, siç është, **për shembull, në titullin "CO i DOM zgjodhi Moraçanin si kandidat për deputet".**[36] Një media publikon një raport gazetaresk me titullin stereotipik gjinor "**LSDM do të kandidojë me tre zonja nga Ohri në 5-shen në zgjedhjet parlamentare".**[37]

Më 25 mars, fokusi i publikimeve në media ishte përcaktimi i rendit në listën e votimit për zgjedhjet presidenciale nga KSHZ-ja. Ndërkohë, në raportet gazetareske, transferohen paraqitjet e mysafirëve të përfaqësuesve të partive, pjesëmarrja e tyre në ngjarje publike, prezantimi i projekteve, etj. Për shembull, kryetarja e komunës së Shkupit Danela Arsovska promovon projekte dhe aksione në qytet, ministrja Kostadinovska Stojçevska promovon projekte kulturore, ministrja Petrovska është në përvjetorin e katërt të anëtarësimit në NATO, etj.

35 Grkovska: Gratë që përballen me pengesa janë më të motivuara në luftën për një shoqëri më të mirë - MKD.MK

36 https://4news.mk/tso-na-dom-ja-izbra-morachanin-za-kandidat-za-pratenik/

37 LSDM do të kandidojë me tre zonja nga Ohri në njësinë zgjedhore 5 - OhridNews

Më 27 mars, dhjetë raporte të lajmeve raportuan për pjesëmarrjen e Kostadinovska Stojçevskës në panelin e diskutimit "Sfidat e gjuhës së urrejtjes: emancipimi dhe barazia e grave në politikë", me tituj të tillë si "**Vetëm me zë të lartë dhe të bashkuar do të kundërshtojmë gjuhën e urrejtjes dhe dhunën gjinore".**[38]

Më 29 mars, raporte të ndryshme të shtypit publikuan deklarata nga intervista e Zajkova për Sllloboden Peçat, të tilla si "**Zajkova: Ligji për barazinë gjinore duhet të sigurojë mundësi të barabarta midis burrave dhe grave"**[39]**,** ku media të ndryshme përqendrohen në pjesë të ndryshme të intervistës. Disa janë senzacionalistë dhe sugjerojnë një kontekst negativ përmes të cilit mund të provokonin audiencën, si për shembull me titullin "**PËR ZAJKOVA DECENTRALIZIMI DHE LEGALIZIMI I KANABISIT NUK DO TË THOTË SE DO TË KETË VARTËS".**[40]

Tridhjetë media raportojnë se Petrovska fitoi padinë për shpifje kundër Dragan Kovaçkit nga VMRO-DPMNE. Një raport gazetaresk me titull**"Slavjanka shkëlqeu me një komplet të kuq në një takim me prodhuesit e pajisjeve ushtarake turke"**[41] raporton një takim zyrtar të ministrit të Mbrojtjes, me fokus vetëm në veshjen e ministres.

Postimetëtilla,veçanërishtkurbëhetfjalëpërpolitikanëtëranguttëlartë, kontribuojnënëobjektivizimineméetejshëmtëtrupittëfemrësdheç'fokusimin në çështjet kryesore politike.

38 Kostadinovska-Stojçevska: Vetëm me zë të lartë dhe të bashkuar do të kundërshtojmë gjuhën e urrejtjes dhe dhunën me bazë gjinore - Utrinski Vesnik

39 Zajkova: Ligji për barazi gjinore duhet të ofrojë mundësi të barabarta midis burrave dhe grave - 24info.mk

40 Për Zajkova DEKRIMINALIZIMI DHE LEGALIZIMI I KANABISIT NUK DO TË THOTË SE DO TË KETË VARTËS

41 Sllavjanka shkëlqen me një komplet të kuq në takimin me prodhuesit e pajisjeve ushtarake turke - Expres.mk

Më 30 mars, disa raporte për shtyp raportojnë deklaratën e Dafina Stojanoskës nga VMRO-DPMNE si bartëse e listës që thotë se

> *si anëtare e gjinisë që e di shumë mirë se çfarë do të thotë dhimbje, barrë dhe padrejtësi, që di të përballojë çdo befasi dhe që di të qajë nga gëzimi, por edhe të qeshë kur është më e vështirë, në emër timin, në emër të të gjitha grave dhe në emër të elektoratit tim, shpreh respekt të madh për kryetarin e VMRO-DPMNE-së, Hristijan Mickoski.*[42]

Në të njëjtën ditë, tetë media raportuan për pjesëmarrjen e Trençevskës në ngjarjen e fundit të fushatës "Me zë dhe guxim 2", e cila synon të inkurajojë gratë dhe të inkurajojë përfshirjen e tyre më të madhe në tregun e punës.[43]

Sllobodën Peçat publikon një analizë "**Vetëm shtatë gra janë mbajtëse të listave parlamentare".**[44] Vetëm një raport gazetaresk raporton një publikim nga media Telegrafi me titull "**Asnjë grua shqiptare nuk udhëheq listën e deputetëve"**[45] në të cilën citon aktivisten Nafije Selmani të ketë thënë se

> *Partitë politike shqiptare nuk e kanë marrë seriozisht pjesëmarrjen e grave në jetën politike dhe në të njëjtën kohë nuk janë të vetëdijshme sa duhet se vetë partitë politike përfitojnë kur gratë marrin pjesë në proceset zgjedhore, janë pjesë e institucionit legjislativ, por kanë edhe pozita menaxheriale. Pjesëmarrja e grave nuk duhet të shihet nga dimensioni i përmbushjes së detyrimit ligjor, por nga pjesëmarrja aktive në jetën politike duke artikuluar kërkesat e gjysmës së popullsisë në vend".*

Në këtë kontekst, më 9 prill, vetëm një media publikoi një intervistë me Imerlije Saliun, kandidate për deputete nga VLEN me titullin "**A do të fitojë Kuvendi deputeten e parë me shami?"**[46]

42 Stojanoska: U bëj thirrje të gjithë qytetarëve të hedhin votën e tyre, për Maqedoninë e tyre - Kanal 5

43 Trençevska: Së bashku, le t'i bëjmë zërat tanë të dëgjohen, ëndrrat tona të bëhen realitet - 24info.mk

44 Vetëm shtatë gra bartëse të listave për deputetë - Free Press

45 Asnjë grua shqiptare nuk udhëheq listën e deputetëve - Expres.mk

46 A do të ketë Kuvendi deputeten e parë femër me shami? - Sllobodën Peçat

Çështjet që lidhen me pjesëmarrjen e grave në politikë, veçanërisht nga komunitetet më të vogla, nuk janë me interes për mediat, edhe pse çështjet etnike janë të përfaqësuara në mënyrë të drejtë në raportet gazetareske për fushatën zgjedhore.

2 prilli është dita e fundit për dorëzimin e listave parlamentare në KSHZ. Vetëm një raport gazetaresk raporton vizitën e Sanela Shkrielj nga LSDM në Sllloboden Peçat me titull "**Beteja ime nuk është me gratë e tjera, por një betejë për të gjitha gratë".**[47] Disa postime gjithashtu shfaqen duke thënë se "**Vankovska shpall veten ateiste, ndërsa fillon fushatën joformale nga manastiret"**, të[48] cilat u publikuan pa autor dhe duke komentuar deklaratat në mediat sociale të shkruara nga Vankovska.

Fillimi i fushatës për zgjedhjet presidenciale

Fillimi zyrtar i fushatës zgjedhore për zgjedhjet presidenciale është më 4 prill. Vetëm katër raporte përcjellin fillimin e fushatës "Rretho JO për Dhunën ndaj Grave në Politikë".[49]

Në raportin gazetaresk me titull "**Kush është Gordana Siljanovska Davkova - e preferuara kryesore për Presidente të Maqedonisë?"**[50] kandidatja paraqitet ekskluzivisht përmes përdorimit të emrave mashkullorë, përkatësisht si

> *Një ekspert i së drejtës kushtetuese dhe profesor në Fakultetin Juridik "Justiniani i Parë", deputet aktiv nga radhët e VMRO-DPMNE-së, një kritik i ashpër i tradhtive kombëtare dhe një luftëtar i ashpër për drejtësi. Kështu mund të përshkruhet shkurtimisht Gordana Siljanovska Davkova, kandidatja e VMRO-DPMNE-së për presidente***."**

47 Shkrijelj: Beteja ime nuk është me gratë e tjera, por një betejë për të gjitha gratë - Free Press

48 Vankovska shpall veten ateiste, ndërsa fillon fushatën joformale nga manastiret - Utrinski Vesnik

49 Televizioni 24: Fillon Fushata "Rretho Jo për dhunën ndaj grave në politikë"

50 Kush është Gordana Siljanovska Davkova - e preferuara kryesore për Presidente të Maqedonisë? - Radio Lider

Dy raporte të mediave raportojnë në mënyrë jokritike kolumnën e Gjorgji Tanushev, këshilltar dhe kryetar i komisionit për mundësi të barabarta të grave dhe burrave në Komunën e Strumicës me titull "**Ka vetëm burra, gra dhe para të mira"**[51] **,** e cila ndan dezinformata gjinore për aktivistët dhe politikanët që avokojnë për barazi gjinore dhe të drejtat e komunitetit LGBTI+. Autori, përmes informacionit të pabazuar dhe fyes në tekst, bën një lidhje me avokimin për barazi gjinore, përfshirë Ligjin e ri për Barazi Gjinore, vetëm për përfitimet personale të politikanëve, si dhe "donatorëve të tyre" të cilët

> *bujarisht "premtojnë"gjëra të ndryshme për organizatat që do të promovojnë " barazi të plotë gjinore " për gratë, por ndoshta kjo vlen vetëm për ato "gra që kanë lindur me penis", dhe sulmet ndaj të ashtuquajturave gra cis janë vetëm për propagandë të mediave në terren.**"**

Dy raporte publikuan deklaratën e "**Kandidates për deputete të BDI-së: Ne jemi aq të gatshëm për të menaxhuar edhe me NASA-n"**[52]**,** por emri i saj nuk përmendet fare. Një raport gazetaresk me titull "**VANKOVSKA KOHËT E FUNDIT U BË GJYSHE PËR HERË TË DYTË Ajo është nëna e**[53] **tre vajzave të suksesshme"** raporton vizitën e Vankovskës në Kanalin 77, por fokusi i postit është vetëm në rolin e saj në familje.

Më 7 prill, disa raportime gazetareske raportuan për mbështetjen publike të Vankovskës nga eurodeputetja Claire Daly, dhe vetëm në një raport u bë intervista në KOD me Robert Scott Hazlett të NDI me titull "**Pesë gra politikane nën sulm të vazhdueshëm në rrjetet sociale."**[54]

51 Ka vetëm burra, gra dhe para të mira

52 Kandidatja për depute e BDI-së: Ne jemi aq të gatshëm sa mund të menaxhojmë edhe me NASA-n - TV21.mk

53 VANKOVSKA KOHËT E FUNDIT U BË GJYSHE PËR HERË TË DYTË Nënë e tre vajzave të suksesshme - plusinfo.mk

54 KOD: Pesë politikane femra nën sulm të vazhdueshëm në rrjetet sociale, intervistë me Robert Scott Hazlett (ND) - telma.com.mk

Edhe pse raportet e shtypit raportojnë për paraqitjet publike të Siljanovska Davkova, vetëm një pjesë e vogël e tyre raportojnë për deklaratat në lidhje me përfshirjen e grave në politikë. Për shembull, në vetëm një postim me titull "**DO TË AFIRMOJ NEVOJËN PËR MË SHUMË GRA NË POZICIONE KYÇE, THA SILJANOVSKA-DAVKOVA NGA[55] KAVADARCI"**, transmetohet deklarata e kandidates e cila thotë:

> *Shoh më shumë gra këtu. Dhe edhe një herë, më lejoni t'ju pyes të gjithëve, dhe burrat, sa e logjikshme është që për 30 vjet nuk kemi pasur një grua presidente, nuk kemi pasur një grua kryeministre, nuk kemi pasur një grua kryetare të Kuvendit. Mos harroni, ne nuk jemi krijesa egoiste, ne vetëm duam të ndihmojmë Maqedoninë të jetë përsëri krenare, me dijen e saj, me mendjen e saj, me krijimin e saj, me përkushtimin e saj. Mos hiqni dorë nga gjysma e popullsisë."*

Në vetëm katër postime nga tubimi në Manastir me titull "**Politika është gjithashtu e gjinisë femërore, me një presidente grua, gratë maqedonase do të bëhen më të suksesshme"**[56] **dhe "DO TUTHEKSOJ BURRAVE SE ATA HEQIN DORË NGA SHUMË MEND, KUR THONË SE NË POLITIKË NUK HYHET ME KUOTA", përpjekjet për të drejtat e grave**[57] transferohen, duke deklaruar se

> *nëse Maqedonia fiton një grua presidente, gratë do të identifikohen me të dhe do të jenë jo vetëm në familje, por më të suksesshme në punë dhe në politikë, sepse edhe politika është e gjinisë femërore."*

Pesë raporte për shtyp më 10 prill përcollën deklaratën e kandidatit presidencial Stevo Pendarovski me titull "**Mickoski duhet t'i japë Siljanovskës një GPS," tha Pendarovski.**[58] Kështu, autorët e raporteve thjesht përcjellin deklaratën dhe nuk e trajtojnë aspak në mënyrë kritike diskriminimin në të**.** Tre raporte gazetareske i referohen **"Mizogjinisë dhe**

55 Do të afirmoj nevojën për më shumë gra në pozita kyçe, thotë Siljanovska-Davkova nga Kavadari

56 Siljanovska-Davkova: Politika është gjithashtu e gjinisë femërore, me një presidente grua, gratë maqedonase do të bëhen më të suksesshme - MKD.MK

57 "DO TUTHEKSOJ BURRAVE SE ATA HEQIN DORË NGA SHUMË MEND, KUR THONË SE NË POLITIKË NUK HYHET ME KUOTA"

58 Mickoski t'i blejë GPS Siljanovskës, eporositi Pendarovski - Fokus

gjuhës diskriminuese: Pendarovski u përpoq të minojë besueshmërinë dhe kualifikimet e Siljanovska Davkova bazuar në gjininë dhe moshën e saj"[59], por ato janë nga një autor i panjohur. Për më tepër, teksti citon postime në mediat sociale të ekspertëve dhe aktivistëve për barazi gjinore, por nuk është e qartë se cilët ekspertë janë të përfshirë, dhe në të njëjtën kohë shfaqet pothuajse i njëjti raport i titulluar "**ANALIZË: sulmet misogjiniste të Pendarovskit ndaj Siljanovska Davkova janë një manifestim i totalitarizmit".**[60]

Dhjetëra publikime me pothuajse të njëjtin titull "**Nikolloski: Trençevska merr para të majme nga Fondacioni Soros për të përfaqësuar barazinë gjinore**[61] **"** përcjellin deklarata nga Aleksandar Nikolloski nga VMRO-DPMNE në të cilat ai flet për Trençevska si një

> *që fëmijët tanë duan t'i mësojë se nuk kishte rëndësi nëse ishin meshkuj apo femra, se nuk ka prindër, por ka prind 1 dhe prind 2, dhe drejton disa të ashtuquajtura politika gjinore për të cilat ata marrin para të majme nga Fondacioni Soros.*"

Kështu, asnjë nga mediat nuk ofron një rishikim kritik ose rishqyrton besueshmërinë e këtyre deklaratave.

59 Mizogjinia dhe gjuha diskriminuese: Pendarovski u përpoq të minojë besueshmërinë dhe kualifikimet e Siljanovska Davkova bazuar në gjininë dhe moshën e saj - Radio Lider

60 "ANALIZË: sulmet misogjiniste të Pendarovskit ndaj Siljanovska Davkova janë një manifestim i totalitarizmit"

61 Nikolloski: Trençevska merr para të mëdha nga Fondacioni Soros për të përfaqësuar barazinë gjinore - Kanal 5

Më 11 prill, një media publikoi një raport gazetaresk me titull "**Kush janë zonjat e para të mundshme dhe zotëria i parë i Maqedonisë?"**[62]**,** në të cilin përdoren stereotipet gjinore, duke deklaruar se

> *me dhënien e funksionit President i shtetit, vjen titulli i destinuar për shokun e jetës së Presidentit, për anëtarët e gjinisë më të butë Zonja e Parë (First lady),, dhe Zotëria i Parë (First gentleman) për anëtarët e gjinisë më të fortë.*"

Më shumë se 10 raporte të lajmeve raportojnë deklaratën e Presidentit të LSDM-së Dimitar Kovaçevski drejtuar Presidentit të VMRO-DPMNE-së Hristijan Mickoski me tituj të tillë si **"Unënuk e kandidova tezen time Zhana për Presidente të vendit, kështu që duhet të eci në të gjithë Maqedoninë",i**[63] cili thotë se

> *ndërsa ecnin me kandidaten e tyre Danella Arsovska në zgjedhjet lokale, ata tani po ecin me kandidaten e tyre presidenciale nëpër Maqedoni."*

